



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 1, datë 26.07.2018

PËR

**SHPLLJEN E 17 ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 7, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; të nenit 4, 9 dhe 28 të Ligjit Nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar; të neneve 30 dhe 31 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”; të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të KKT-së Nr.3, datë 20.06.2018 “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e turizmit”, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Shpalljen si zona me përparësi zhvillimin e turizmit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të 17 zonave të listuara si më poshtë:
 - 1.1. Mali i Dajtit – Bizë – Martanesh – Qafështamë – Krastë, me sipërfaqe 643,48 Km²;
 - 1.2. Liqenet e Prespës dhe Ohrit, me sipërfaqe 589,97 Km²;
 - 1.3. Lurë – Dejë, me sipërfaqe 200,95 Km²;
 - 1.4. Shebenik – Jabllanicë, me sipërfaqe 339,24 Km²;
 - 1.5. Vargmali i Moravës, me sipërfaqe 169,57 Km²;
 - 1.6. Liqeni i Ulzës, me sipërfaqe 42,03 Km²;
 - 1.7. Kanionet e Nivicës, me sipërfaqe 125,78 Km²;
 - 1.8. Pllaja e Dumresë, me sipërfaqe 243,73 Km²;
 - 1.9. Korab - Koritnik, me sipërfaqe 555,98 Km²;
 - 1.10. Korçë, me sipërfaqe 34,99 Km²;
 - 1.11. Alpet, me sipërfaqe 1238,67 Km²;
 - 1.12. Brezi Bregdetar, me sipërfaqe 1518,95 Km²;
 - 1.13. Kanionet e Osumit, me sipërfaqe 55,59 Km²;
 - 1.14. Rinasi, me sipërfaqe 15,31 Km²;
 - 1.15. Lugina e Vjosës – Zagori, me sipërfaqe 441,19 Km²;
 - 1.16. Mali i Tomorrit, me sipërfaqe 260,85 Km²;

1.17. Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna, me sipërfaqe 419,03 Km².

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë:

- a. Harta e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;
- b. Kufijtë elektronikë, në format vektorial, të zonave me përparësi zhvillimin e turizimit (CD).

3. Shpallja e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, bëhet në funksion të:

- nxitjes së turizmit cilësor e të qëndrueshëm duke koordinuar e orientuar investimet publike e nxitur investimet private në këto zona;
- arritjes së ekuilibrit mes zhvillimit të turizimit dhe mbrojtjes së pasurive natyrore, kulturore dhe historike;
- përdorimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të zonave, përmes hartimit të planeve të detajuara të zhvillimit e veprimit për secilën prej tyre;
- hartimit dhe implementimit të politikave të veçanta nxjtëse për secilën zonë;
- rritjes së cilësisë së shërbimeve turstike duke kontrolluar zhvillimin dhe duke nxitur investime në struktura akomoduese me 4-5 vje, në përshtatje me karakteristikat natyrore të zonave.

4. Zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, janë zona të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit dhe janë subjekt i planifikimit kombëtar, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Gjatë hartimit të planeve sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga përcaktimet e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e këtij Vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit që përfshihen në këto zona për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BLENDI KLOSI

MINISTËRI TURIZMIT DHE MJEDISIT



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTORI I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

